VENDIM
Nr.656, datë 27.9.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.95, DATË 13.2.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN NË QARQE TË DREJTORIVE RAJONALE TË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT"

Në mbështetje të neneve 95 e 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.95, datë 13.2.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për krijimin, në qarqe, të drejtorive rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit".

b) Në pikat 1 dhe 2 emërtimi "Drejtorive rajonale të bujqësisë dhe të ushqimit (DRBU)" zëvendësohet me "Drejtorive rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit".

c) Kudo në vendim emërtimet "Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit" dhe "Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit" zëvendësohen, përkatësisht, me "Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit" dhe "Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit".

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, e Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha